



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

SHTOJCË PËR HEQJEN NGA PEZULLIMI TE PROCEDURËS

Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me synim nxitjen e konkurrencës mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, vendos rifillimin e procedurës së dhënies me koncesion/PPP me objekt “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, dhe transferim i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës”, duke hequr në datën 23.11.2020, nga pezullimi procedurën e shpallur me datën 19.12.2019.

Ky vendim ndërmerret në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Sa më sipër, data e heqjes së procedurës nga pezullimi është data 23.11.2020.

IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:

ISHTE: Brenda dhe jo me vonë se: Data: 21/04/2020 Ora: 13:00 Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

BËHET: Brenda dhe jo me vonë se: Data: 14/12/2020 Ora: 13:00 Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

KOMISIONI I DHËNIES SË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT